

20150200412

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIM PENSIONAL DHE
INVALIDOR

Neni 1

Në Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14 dhe 188/14), në nenin 11, paragrafi (1), pika 15) ndryshohet si vijon:

"personi i cili realizon të hyra nga kryerja e punës fizike dhe/ose intelektuale, në bazë të një ose më shumë marrëveshjeve për vepër dhe/ose marrëveshjeve autoriale ose marrëveshjeve tjera, me të cilat është përcaktuar kompensim për punën e kryer, nëse shuma e përgjithshme neto e të hyrave mbi atë bazë është më e lartë se shuma e rrogës minimale të përcaktuar me ligj."

Neni 2

Në nenin 120, pas paragrafit (3) shtohet paragrafi i ri (4), si vijon:

"(4) I siguruari i cili paguan kontribut në shtyllën e dytë pensionale, ka llogari individuale dhe është anëtar në fondin e obligueshëm pensional, nuk paguan kontribut në shtyllën e dytë pensionale për kompensimin për kryerjen e punës fizike dhe/ose individuale, në bazë të marrëveshjes për vepër dhe/ose marrëveshjeve autoriale ose marrëveshjeve tjera me të cilat është përcaktuar kompensim për punën e kryer."

Neni 3

Në nenin 125 paragrafi (4) pika 1. ndryshohet si vijon:

"punëdhënësi - për punëtorët e punësuar te ai".

Pika 5) ndryshon si vijon:

"personat nga neni 11 paragrafi (1), pikat 4), 5), 6) dhe 14) të këtij ligji".

Pas paragrafit (6), shtohet paragrafi i ri (7) si vijon:

"(7) Me përjashtim të paragrafëve (5) dhe (6) të këtij neni, cilësia e të siguarit për personat nga neni 11, paragrafi (1), pika 15), vendoset edhe nëpërmjet fletëparaqitjes për shumën e pranuar në bazë të marrëveshjes në vepër dhe/ose marrëveshjes autoriale ose marrëveshjes tjetër, të cilën në përputhje me ligjin e dorëzon personi i cili ka realizuar kompensim."

Neni 4

Në nenin 148 pas paragrafit 1 shtohet paragrafi i ri (2), si vijon:

"(2) Shfrytëzuesit të pensionit i cili krahas pensionit realizon edhe të hyra nga kryerja e punës fizike dhe/ose intelektuale, në bazë të një ose më shumë marrëveshjeve për vepër dhe/ose marrëveshjeve autoriale ose marrëveshjeve të tjera me të cilat është përcaktuar kompensim për punën e kryer, nuk i ndalohe pagesa e pensionit.

Paragrafi (2) bëhet paragraf (3).

Neni 5

Në nenin 198 pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

"(2) Në evidencën amë shënohen të dhëna edhe për:

1. të siguarin i cili krahas të hyrave nga marrëdhënia e punës, vetëpunësimi, realizon të hyra edhe nga kryerja e punës fizike dhe/ose intelektuale, në bazë të një ose më shumë marrëveshjeve për vepër dhe/ose marrëveshjeve autoriale ose marrëveshjeve tjera, me të cilat është përcaktuar kompensim për punën e kryer, nëse shuma e përgjithshme neto e të hyrave mbi atë bazë është më e lartë se shuma e pagës neto mesatare për vitin paraprak, e publikuar nga Enti Shtetëror i Statistikës;

2. të siguruarin në marrëdhënie pune i cili realizon të hyra nga kryerja e punës fizike dhe/ose intelektuale, në bazë të një ose më shumë marrëveshjeve për vepër dhe/ose marrëveshjeve autoriale ose marrëveshjeve tjera me të cilat është përcaktuar kompensim për punën e kryer me punëdhënësin të i cili është në marrëdhënie pune ose me persona të tjerë juridikë të cilët kanë lidhje pronësore, organizative ose menaxhuese me punëdhënësin;

3. shfrytëzuesin e pensionit i cili krahas pensionit realizon edhe të hyra nga kryerja e punës fizike dhe/ose intelektuale, në bazë të një ose më shumë marrëveshjeve për vepër dhe/ose marrëveshjeve autoriale ose marrëveshjeve tjera, me të cilat është përcaktuar kompensim për punën e kryer, nëse shuma e përgjithshme neto e të hyrave mbi atë bazë është më e lartë se shuma e pagës mesatare neto për vitin paraprak, e publikuar nga Enti Shtetëror i Statistikës."

Neni 6

Në nenin 199 pika 1. ndryshohet si vijon:

"punëdhënësit - për punëtorët e punësuar te to;".

Pika 7 ndryshon si vijon:

"personat nga neni 11, paragrafi (1), pika 15 e këtij ligji, nëse realizojnë të hyra nga kryerja e punës fizike dhe/ose intelektuale, në bazë të një ose më shumë marrëveshjeve për vepër dhe/ose marrëveshjeve autoriale ose marrëveshjeve tjera, me të cilat është përcaktuar kompensim për punën e kryer, nëse shuma e përgjithshme neto e të hyrave mbi atë bazë është më e lartë se shuma e pagës minimale të përcaktuar me ligj."

Pas paragrafit (1) shtohet paragrafi i ri (2), si vijon:

"(2) Fondi vendos dhe mban të dhëna për personat nga neni 198 paragrafi (2) i këtij ligji".

Neni 7

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".